

K O N T R A T E

PER

THEMELIMIN E SHOQERISE

SHQIPTARO-GREKE "INTERMEDICA CENTER" SH. A

E lidhur me 21/05/1996, ne Tirane midis paleve :

1. Vasilis Magjiras, i biri i Jorgeos, i datelindjes 1964 shtetas grek, i pajisur me leternjoftimin Nr H 262169, leshuar nga policia e Athines (Greqi), banues ne Athine Greqi, biznesmen, person fizik, me zotesi te plote per te vepruar, i cili vepron sipas legjislacionit grek.

2. Jorgos Papagocis, i biri i Athanasios, i datelindjes 1950, shtetas grek, i pajisur me leternjoftimin Nr M 060562, leshuar nga policia Athine (Greqi), banues ne Athine, biznesmen, person fizik me zotesi te plote per te vepruar, i cili vepron sipas legjislacionit grek.

3. Vasil Llajo, i biri i Spiros, i datelindjes 1956, i pajisur me leternjoftimin Nr. 259443, leshuar nga zyra e gjendjes civile Sarande, banues ne Tirane, person fizik, i cili vepron ne baze te legjislacionit shqiptar.

Nisur nga deshira per bashkepunim, me vullnetin e tyre te lire dhe mbeshtetur ne legjislacionin ne fuqi te Republikes se Shqiperise, palet e mesiperme rane dakord per sa me poshte :

NENI I

Te krijone nje Shoqeri shqiptaro-greke me emertimin "INTERMEDICA CENTER" Sh.A.
Forma e Shoqerise do te jete Shoqeri Anonime.

"INTERMEDICA CENTER" Sh.A, do te jete person juridik shqiptar dhe aktiviteti i saj do te zhvillohet ne baze te legjislacionit shqiptar dhe ne perputhje me legjislacionin e marreveshjet nderkombetare, marreveshjet dy paleshe Shqiperi-Greqi, si dhe ne baze te Statutit te kesaj Shoqerie, pjese perberese e te cilit do te jete edhe kjo Kontrate.

NENI 2

Selia e Shoqerise Tregetare "INTERMEDICA CENTER" Sh.A, do te jete ne Tirane (Shqiperi), ne Rrugen "ERFAN TOMINI", Nr...5...

NENI 3

Kohezgjatja e Shoqerise percaktohet ne 30 (tridhjete) vjet. Ky afat fillon ne daten e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane dhe mund te perseritet ose zgjatet ne marrevshje midis paleve.

NENI 4

Shoqeria Tregetare "INTERMEDICA CENTER" ka per objektiv kryesor :

- Ushtrimin e aktivitetit diagnostikues dhe kurues ne sherbim te shendetit te popullit dhe parandalimit te semundjeve te ndryshme (profilaksise).
- Kurimi i semundjeve te ndryshme ne kushte spitalore dhe ambulatorore.
- Organizimi i sherbimit te urgjences (ndihmes se shpejte) ne raste aksidentesh, zjarresh, termetesh dhe fatkeqesish te tjera natyrore.
- Organizimi i sherbimit obstetrik - gjinekologjik ne perputhje me kerkesat e shkences bashkekohore ne lidhje me kete sherbim.
- Importimi i aparaturave dhe pajisjeve elektro-mjekesore bashkekohore te barnave dhe prodhimeve te tjera te industrise farmaceutike dhe tregetimin e tyre me shumice dhe pakice.
- Te marre me qera, te bleje, ose te ndertoje godina dhe mjedise te tjera te pershtatshme per ushtrimin e aktivitetit sipas percaktimeve te ketij neni.
- Te ushtroje cdo veprimtari te ligjshme financiare dhe tregetare brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise, veprimtari qe ka lidhje me pasurite e tundshme dhe te patundshme te lidhura direkt ose indirekt me objektin e veprimtarise se Shoqerise Tregetare "INTERMEDICA CENTER" qe konsiderohet e nevojshme ose fitimpruresse per interesat e kesaj Shoqerie.

NENI 5

Kapitali themelues i shoqerise Tregetare "INTERMEDICA CENTER" Sh.A do te jete \$ 20.000 (njezetmije) USD. Kontributi i ortakeve ne kapital dhe perberja e tij do te jete si me poshte:

Ortakët me shtetesi greke do të kontribuojnë në shoqëri, duke sjellë nga jashtë shtetit aparaturë dhe pajisje elektromjekësore bashkëkohore me vlerë \$ 13.600 (trembëdhjetëmijëgjashtëqind) USD, sipas listave Nr. 1 dhe 2 që i bashkëngjiten kësaj kontrate.

Prej tyre :

a) Ortaku Vasilis Magjiras do të kontribuojë me aparaturë dhe pajisje elektromjekësore me vlerë \$ 6.800 (gjashtëmijëtetëqind) USD, baraz me 34 % të kapitalit.

b) Ortaku Jorgos Papagocis do të kontribuojë me aparaturë dhe pajisje elektromjekësore me vlerë \$ 6.800 (gjashtëmijëtetëqind) USD, baraz me 34 % të kapitalit.

c) Ortaku Vasil Llajo do të kontribuojë në shoqëri duke depozituar për krijimin e kapitalit të saj \$ 6.400 (gjashtëmijëkaterqind) USD, baraz me 32 % të kapitalit.

Ky ortak do të kontribuojë në shoqëri edhe me shërbimin e kualifikuar mjekësor që ka dhe do të vejë në dispozicion të tij.

Fitimi midis ortakëve të Shoqërisë do të ndahet në baze të përpjesëtimeve të kontributit të tyre në kapital, si në paragrafin e mësipërm të këtij neni.

NENI 6

Aparaturat dhe pajisjet elektromjekësore që do të sillen si kontribut në kapitalin e shoqërisë nga ortakët me shtetesi greke do të jenë i dokumentuara në përputhje me legjislacionin doganor në fuqi të tedy vendeve (Shqipëri-Greqi ose çdo shtet tjetër ku ato janë blerë), dhe do të evidentohen në librat e llogarise së shoqërisë "INTERMEDICA CENTER." Sh.A, duke pasqyruar, edhe shpenzimet, sipas perkatesisë të pales që i kryen ato, si për blerjet, detyrimet doganore, transportin, instalimin etj.

Shpenzimet e bera, si me siper, do të pasqyrohen në dollare ose çdo valute tjetër të huaj në të cilin janë kryer në fakt dhe përfundimisht, do të konvertohen në LEKE (monedhë shqiptare) me kursin zyrtar të dollarit ose valutes tjetër të huaj me LEKUN, ditën e kryerjes së pageses.

Sasite ose pjesët e aparaturave elektromjekësore, kontribut i ortakëve me shtetesi greke, me vlerë me të madhe se detyrimi i tyre si kontribut në

kapital (d.m.th. mbi \$ 13.600.) do te evidentohen ne librat e llogarise se shoqerise "INTERMEDICA CENTER" Sh.A. njelloj si ne dy paragrafet e meparshme te ketij neni, dhe vlera e tyre do t'u shlyhet ortakeve me shtetesi greke nga shoqeria tregtare "INTERMEDICA CENTER" Sh. A, sipas marreveshjes se ortakeve qe do te arrihet midis tyre, rast pas rasti.

• Ne te njejten menyre do te veprohet edhe ne eventualitetin e shpenzimeve qe mund te kryeje ortaku shqiptar Vasil Llajo qe tejkalojne detyrimin e tij si kontribut ne kapital (d.m.th, mbi \$ 6.400), sipas shkronjes "C" te nenit 5 te kesaj kontrate.

NENI 7

Marredheniet e punesimit ne Shoqerine Tregtare "INTERMEDICA CENTER." Sh. A do te rregullohen ne perputhje me kerkesat e Kodit te Punes se Republikes se Shqiperise.

NENI 8

Palet u moren vesh qe te punojne me deshire dhe vullnet te mire per realizimin e kushteve te kesaj kontrate.


Mosmarreveshjet qe nuk do te arrihet te zgjidhen me mirekuptim do te zgjidhet ose ne Arbitrazhin e Dhomes Nderkombetare te Tregetise se Parisit ose ne Qendren Nderkombetare per Zgjidhjen e Mosmarreveshjeve te Investimeve ("Qendra"), ngritur me Konventen per zgjidhjen e Mosmarreveshjeve te Investimeve ndermjet Shteteve dhe Shtetasve te Shteteve te tjera, miratuar ne Washington me 18 Mars 1965, ne baze te Legjislacionit Francez dhe Parimeve te se Drejtes Nderkombetare.

Kompetenca e ketyre Arbitrazheve eshte paralele ne kuptimin qe paraqitja e Kerkeses ne njerin prej ketyre Arbitrazheve nuk i heq te drejten Pales (Ortakut) t'i drejtohet njekohesisht edhe Arbitrazheve te tjere.


Kjo Kontrate u hartua ne gjuhet shqip dhe anglisht, me nga 4 kopje sejcila me permbajtje te njejte.

Ne rast interpretimi kontradiktor, si baze do te sherbeje gjuha angleze.


Vasilis Magjiras



Jorgos Papagocis



Vasil Llajo



STATUTI

I SHOQERISE ANONIME "INTERMEDICA CENTER" SH.A.

NENI 1

Ne baze te kontrates date 21/05/1996, lidhur per krijimin e Shoqerise Anonime "INTERMEDICA CENTER" Sh.A., ortake te kesaj Shoqerie jane:

1. Vasilis Magjiras, i biri i Jorgeos, i datelidjes...1964..., shtetas grek, i pajisur me leternjoftimin Nr H262169, leshuar nga organet e policise greke te Athines, me banim ne Athine (Greqi), person fizik, biznesmen, i cili vepron te baze te legjislacionit grek.

2. Jorgos Papagocis, i biri i Athanasios, i datelindjes 1950..., shtetas grek, i pajisur me leternjoftimin Nr M060562, leshuar nga organet e policise greke te Athines, me banim ne Athine (Greqi), person fizik, biznesmen, i cili vepron ne baze te legjislacionit grek.

3. Vasil Llajo, i biri i Spiros, i datelindjes 1956..., i pajisur me leternjoftimin Nr. 259443, leshuar nga zyra e gjendjes civile Sarande, banues ne Tirane, person fizik, i cili vepron sipas legjislacionit shqiptar.

NENI 2

Shoqeria Tregetare "INTERMEDICA CENTER" Sh.A eshte Shoqeri pa oferte publike. Ajo zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe dispozitat e ketij statuti, si dhe marreveshjes se arritur me Kontraten date 21/05/1996, nenshkruar prej Ortakeve te permendur ne nenin e mesiperm, e cila eshte pjese perberese e Statutit.

NENI 3


Emertimi i Shoqerise eshte "INTERMEDICA CENTER" Sh.A. Selia e saj do te jete ne Shqiperi, ne qytetin e Tiranës, Rruga "IRFAN TOMINI" Nr. 5..... Vula e Shoqerise do te kete pershkrimin sipas permbajtjes se kesaj dispozite te Statutit.

NENI 4

- 
- Shoqeria Tregetare "INTERMEDICA CENTER."Sh.A ka per objektiv kryesor :


Ushtrimin e aktivitetit diagnostikues dhe kurues ne sherbim te shendetit te popullit dhe parandalimit te semundjeve te ndryshme (profilaksise).

- Kurimin e semundjeve te ndryshme ne kushte spitalore dhe ambulate.
- Organizimin e sherbimit te urgjences (ndihmes se shpjete) ne raste aksidentesh, zjarresh, termetesh dhe fatkeqesish te tjera natyrore.
- Organizimin e sherbimit obstetrik - gjinekologjik ne perputhje me kerkesat bashkekohore ne lidhje me kete sherbim.
- Importimin e aparaturave dhe pajisjeve elektro-mjekesore bashkekohore te barnave dhe prodhimeve te tjera te industrise farmaceutike dhe tregetimin e tyre me shumice dhe pakice.
- Te marre me qera, te bleje ose te ndertoje godina dhe mjedise te tjera te pershtatshme per ushtrimin e aktivitetit sipas percaktimeve te ketij neni.
- Te ushtroje cdo veprimtari te ligjshme financiare dhe tregetare brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise, veprimtari qe ka lidhje me pasurite e tundshme dhe te patundshme te lidhura direkt ose indirekt me objektin e veprimtarise se Shoqerise Tregetare "INTERMEDICA CENTER"Sh.A qe konsiderohet e nevojshme ose fitimprurese per interesat e kesaj Shoqerie.

NENI 5


Kohezgjatja e Shoqerise Tregetare "INTERMEDICA CENTER" Sh.A, do te jete per 30 vjet. Aktiviteti i saj do te filloje pas regjistrimit ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane, moment nga i cili fiton personalitet juridik.

Ky afat mund te zgjatet ose te perseritet ne marreveshje midis ortakeve, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.



Veprimtaria e Shoqerise Tregetare "INTERMEDICA CENTER."Sh.A, pushon para afatit te parashikuar ne paragrafin e mesiperm vetem me vendim unanim (te njezeshem) te Ortakeve si dhe ne rastet e tjera te parashikuara nga Legjislacioni Shqiptar.

NENI 6

Kapitali i Shoqerise "INTERMEDICA. CENTER" Sh.A eshte 20.000 (mijezetmije) USD. Ortaket marrin pjese ne krijimin e Kapitalit Themeltar me kthotat ne natyre dhe monedhe sipas percaktimit ne Kontraten date 21/05/1996 nenshkruar prej tyre, i cili perbehet nga vlera e aparaturave dhe pajisjeve elektro-mjeksore, lloji dhe specifikimet e te cilave perskruhen ne listat nr. 1 dhe 2 bashkangjitur, qe jane pjese perberese e ketij statuti dhe te cilat perbejne kontributin e ortakeve vasilis Magjiras dhe Jorgos Papagocis, si dhe nga shuma prej 6.400 USD qe do te perbeje kontributin e ortakut Vasil Llajo.

Pjesa e kontributit te Ortakeve ne kapital, ashtu sic eshte percaktuar edhe ne kontraten date 21/05/1996, e vleresuar ne dollare amerikan dhe ne monedhe, po ne dollare amerikan do te jete:

- a) Vasilis Magjiras \$ 6.800 USD baraz me 34 % te kapitalit.
- b) Jorgos Papagocis : \$ 6.800 USD, baraz me 34 % te kapitalit.
- c) Vasil Llajo \$ 6.400 USD, baraz me 32 % te kapitalit.

Ne baze te ketyre perpjestimeve do te ndahen edhe fitimet midis ortakeve te Shoqerise Tregetare "INTERMEDICA. CENTER" Sh. A.

NENI 7

Kapitali themeltar eshte \$ 20.000 USD, i ndare ne aksione Nominative me vlere \$ 500 USD, secili aksion ^{eshte e} se njejtës klase dhe ^{me} numer serie nga 1 - 4.000 nga te cilat :

- 1360 aksione me numer serie nga 1 - 1360 i jepen zotit Vasilis Magjiras.
- 1360 aksione me numer serie nga 1361 - 2720i jepen zotit Jorgos Papagocis.
- 1280 aksione me numer serie nga 2721 - 4000 i jepen zotit Vasil Llajo.

NENI 8

Aksionet jane plotesisht te shlyeshme dhe te formes nominative. Ato jane te pakthyeshme kundrejt shoqerise. Shlyerja e aksioneve mund te behet ne nje banke shqiptare (shterore ose private), ose ne nje banke te huaj, sipas percaktimeve te Legjislacionit Shqiptar.

Nenshkrimet e aksioneve dhe shumat e derdhura evidentohen ne nje certifikate te dhene nga Bankat e lartpermendura. Ne rast humbjeje te certifikates Nominative, mbajtési (aksioneri), duhet te njoftoje Shoqerine Anonime dhe te publikoje nje deklarate personale per humbjen ne nje fletore

zyrtare te botuar ne Republiken e Shqiperise ose te ndonje vendi tjeter ku ndodhet banka ne te cilen eshte parashikuar se mund te shlyhen aksionet.

Per nje periudhe prej nje viti nga ky publikim, aksioneri nuk mund te kerkoje pagimin e asnje dividenti. Me kalimin e ketij afati, ne rast se certifikata nuk eshte gjetur, aksionerit i leshohet nje dublikate e certifikates se humbur.

Shpenzimet e kesaj procedure i ngarkohen aksionerit qe ka humbur certifikaten.

NENI 9

Ne rast se perfshirja ne kapital e rezervave, fitimeve ose primeve te emetimit, shoqerohet me dhenien e aksioneve te reja, aksionareve te Shoqerise. E drejta e perparesise eshte e tregtueshme, me perjashtim te rastit kur e vendos shprehimisht Asambleja ne kushtet e parashikuara nga paragrafi II i nenit 152 te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare".

Ne rast se njeri prej ortakeve deshiron te shese pjesen e vet ne kapital, ai duhet t'ia ofoje me perpara ortakeve te tjere dhe ne rast se ata nuk pranojne ta blejne, ortaku qe kerkon t'a shese, ka te drejte t'ia ofroje cdo personi tjeter me kusht qe cmimi per te tjeret te mos jete me i ulet nga ai me te cilin i eshte ofruar ortakeve te tjere.

NENI 10

Shoqeria Tregetare "INTERMEDICA CENTER" Sh. A, mban nje regjister te vecante ne te cilin regjistron :

- Aksionet nominative me treguesit perkates te operacioneve te transferimit dhe te shnderrimit te aksioneve.
- Datat e operacioneve.
- Emrat, mbiemrat dhe adresat e banimit te vjeter dhe te ri (ne rast transferimi) te titullareve te aksionit.
- Emrat, mbiemrat dhe adresat e banimit te titullareve te aksionit ne rast shnderrimi te aksioneve (nga Nominative ne aksione per pruresin dhe anasjelltas).
- Vlera minimale dhe numri i aksioneve te transferuar dhe te shnderruar.

NENI 11

Me perjashtim te rasteve te trashegimise, transferimi i pronesise me aksione nje personi te trete, pavaresisht nga baza juridike e ketij transferimi, mund te behet vetem me pelqimin e ortakeve te shoqerise "INTERMEDICA CENTER" Sh. A, dhene ne kushtet e parashkruara nga neni 207 i Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" dhe nenit 9 te ketij Statuti.

NENI 12

Ortaket e shoqerise tregetare "INTERMEDICA CENTER" Sh. A, shtetas te huaj, pjesen e fitimit te tyre realizuar gjate aktivitetit te kesaj shoqerie, mund t'a transferojne lirisht jashte territorit te Republikes se Shqiperise ne monedhe shqiptare ose cdo monedhe tjetere te huaj te konvertueshme me te, nepermjet bankave ose me cdo menyre tjetere qe nuk eshte e ndaluar me ligj.

Pjesa e fitimit te ortakeve shtetas te huaj, mund te transferohet jashte territorit te Republikes se Shqiperise, si me siper, pasi te jene likuiduar prej tyre detyrimet fiskale dhe detyrimet e tjera qe rrjedhin nga legjislacioni shqiptar ne lidhje me kete fitim.


Viti ekonomiko-financiar fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor te cdo viti, me perjashtim te vitit te pare, i cili do te filloje ditene e fillimit te aktivitetit (pas regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane) dhe do te perfundoje me 31 dhjetor 1996.

Evidentimi i te dhenave ekonomiko-financiare, mbajtja e librave te llogarise dhe nxjerrja e bilanceve do te behen ne perputhje me ligjin shqiptar per kontabilitetin.

NENI 13

Organet Drejtuese te Shoqerise Anonime "INTERMEDICA CENTER" Sh. A, jane :

- Asambleja e Pergjithshme (Aksionereve)
- Keshilli Mbikqyres
- Drejtoria (Drejtori).


NENI 14


Organi Vendimor i Shoqerise Tregetare "INTERMEDICA CENTER" Sh.A, eshte Asamblea e Pergjithshme.

Ky organ mblidhet ne mbledhjet e zakonshme te tij te pakten 1 here ne vit brenda 6 muajve qe pasojne mbylljen e vitit financiar.

Mbledhja e zakonshme e Asamblese se Pergjithshme thirret nga Keshilli Mbikqyres ose Drejtori. Ne mungese ajo mund te thirret gjithashtu nga :


- Ekspertet Kontabel te autorizuar
- Likuidatoret



Thirrja e Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme behet nepermjet lajmerimit me shkrim te pakten 15 dite perpara, duke njoftuar edhe rendin e dites, me shkrim dhe me poste rekomande. Asamblea e Pergjithshme mund te thirret edhe ne mbledhje te jashtezakonshme kur kete e kerkon 2/3 e anetareve te saj per te shqyrtuar ceshtje te kompetences se saj. Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme, pervec vendit ku ka seline Shoqeria Anonime "INTERMEDICA CENTER" Sh.A, mund te thirret ne nje vend tjeter brenda territorit te Republikes se Shqiperise ose jashte ketij territori.

NENI 15


Aksioneret qe marrin pjese ne mbledhjet, vete ose me perfaqesim ligjor, kane te drejte vote ne propocion me numrin e aksioneve qe zoterojne. Cdo aksioner jep te drejten e nje vote.



Per te qene e vlefshme (Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme) ne mbledhjet e saj duhet te jene te pranishem ose te jene te perfaqesuar mbi 1/2 e aksionereve. Cdo aksioner ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e Asamblese.

NENI 16

Asambleja e Aksionereve (Ortakeve) ka kompetence te vendose:

- 
- a. Per emerimin e 2/3 te Anetareve te Keshillit Mbikqyres.
 - b. Per ndryshimet ne statutin e Shoqerise Anonime.
 - c. Per zmadhimin ose zvogelimin e Kapitalit Themeltar te Shoqerise.

d. Per Zgjatjen ose Pushimin e Veprimtarise se Shoqerise para afatit te parashikuar ne Nenin 5 te ketij Statuti dhe likuidimin e saj.

e. Shqyrton rezultatet financiare te shoqerise.

Vendimet per ceshtjet e parashikuara nga pikat b, c, d te ketij Neni merren me votat e 3/4 te Aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar. Vendimet per ceshtjet e tjera merren me 1/2 e votave te Aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar.

NENI 17

Keshilli Mbikqyres i Shoqerise Anonime "INTERMEDICA CENTER" Sh.A perbehet nga anetare, 2/3 e te cileve emerohen nga mbledhja themeluese e Asamblese se Pergjithshme ose nga mbledhja e zakonshme.

Kohezgjatja e Anetareve te Keshillit Mbikqyres te emeruar nga Asambleja percaktohet 6 vjet. Asnje anetar i Keshillit Mbikqyres nuk mund te jete anetar i Drejtorise.

Nje e Treta e anetareve te Keshillit Mbikqyres zgjidhet nga te punesuarit ne Shoqerine Anonime "INTERMEDICA CENTER" Sh.A, te cilet duhet te jene ne radhet e te punesuarve qe kane nenshkruar kontrate pune te pakten dy vjet perpara dates se emerimit ne kete Keshill.

Te gjitha te punesuarit e shoqerise, qe kane lidhur kontrate pune ne kete shoqeri mbi tre muaj para dates se zgjedhjeve, konsiderohen zgjedhes per efektet e paragrafit paraardhes te ketij Neni.

Kandidatet paraqiten me firmen e 1/20 te numrit te pergjithshem te shoqerise. Votimi behet i fshehte.

Ne rast barazimi Votash, kandidati qe ka kontraten me te vjeter te punes konsiderohet fitues.

Mandati i anetareve te Keshillit Mbikqyres te zgjedhur nga te punesuarit eshte i papajtueshem me cdo mandat tjeter perfaqesues te te punesuarve te Shoqerise.

Prishja e kontrates se punes me Shoqerine Anonime "INTERMEDICA CENTER" Sh.A i jep fund mandatit te zgjedhur nga te punesuarit. Kohezgjatja e anetareve te zgjedhur nga te punesuarit percaktohet 3 vjet.

Te dy kategorite e anetareve te Keshillit Mbikqyres, me konsumimin e afatit te parashikuar si me siper mund te rizgjidhen.
Ne rastin e vendeve bosh qe krijohen nga doreheqja , vdekja apo forca te tjera madhore te nje apo disa anetareve te Keshillit Mbikqyres, vet ky Keshill mundet qe, per peiudhen midis dy Mbledhjeve te Asamblese te beje emerime te perkohshme.

NENI 18

Keshilli Mbikqyres zgjedh nga gjiri i vet nje KRYETAR. Ai drejton mbledhjet e Keshillit Mbikqyres dhe debatin ne to.

Keshilli Mbikqyres mund te marre vendime vetem kur ne mbledhjet e tij jane te pranishem, te pakten gjysma e anetareve te tij ose te perfaqesuesve te tyre. Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem ose perfaqesuesve te tyre.

NENI 19

Keshilli Mbikqyres ka keto Kompetenca :

- Emeron dhe shkarkon anetaret e Drejtorise (Drejtorin), duke ngarkuar njerin prej tyre me cilesine e Drejtorit.
- Ushtron kontroll te vazhdueshem mbi Drejtorine lidhur me administrimin e Shoqerise prej saj.
- I paraqet Mbledhjes se Asamblese se Aksionereve konkluzionet e shqyrtimit te Raporteve Vjetore te Drejtorise.
- Zgjedh nga gjiri i saj KRYETARIN, ZEVENDESKRYETARIN.

Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres jane te vlefshme vetem kur ne to marrin pjese mbi 1/2 e anetareve te tij. Vendimet merren me shumice votash te mbi 1/2 e anetareve te pranishem ose te perfaqesuar.
Ne rast rezultati te barabarte votash, vota e KRYETARIT te Keshillit Mbikqyres eshte vendimtare.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te marrin pjese, me Vote Konsultative, ne te gjitha mbledhjet e Asamblese se Aksionareve (Ata kane vote vendimore ne Asamble vetem kur e zoterrojne ate ne cilesine e aksionerit).

NENI 20

Shoqeria Anonime "INTERMEDICA CENTER" Sh.A drejtohet nga DREJTORI dhe ZEVENDESDREJTORI, te cilet emerohen dhe shkarkohen nga Keshilli Mbikqyres, i cili cakton dhe shperblimin e tyre.

Kohezgjatja e mandatit te Drejtorit dhe Zevendesdrejtorit te "INTERMEDICA CENTER" Sh.A eshte 3 vjet, me te drejte perseritje.

NENI 21

Drejtori ka kompetenca te plota per te vepruar ne cdo rrethane ne emer te Shoqerise Anonime "INTERMEDICA CENTER" Sh.A. Kompetencat e tij i ushtron brenda objektit te veprimtarise se Shoqerise, parashikuar ne nenin 4 te ketij Statuti.

Drejtori nuk ka te drejte te ushtroje ato kompetenca qe, sipas ligjit dhe Statutit , u jepen vetem Asamblese dhe Keshilli Mbikqyres.

Vendimet e Drejtorise qe kane te bejne me probleme ekonomike-financiare te rendesishme , me organizimin e punes dhe fuqine punetore si dhe per ato per te cilat kerkohet nga vete Kryetari i Keshillit Mbikqyres qe para se te merret pelqimi i tij, nuk mund te merren pa u marre me pare pelqimi i ketij te fundit.

Te drejten e perfaqesimit te Shoqerise Anonime "INTERMEDICA CENTER" Sh.A ne marredhenie me te Tretet e kane si Drejtori dhe ZevendesDrejtori i Shoqerise, me autorizim me shkrim nga i pari.

NENI 22

Drejtori cdo tre muaj i paraqet Raport Keshillit Mbikqyres per veprimtarine e saj, ndersa pas mbylljes se vitit financiar i paraqet raport Asamblese se Aksionereve per gjendjen ekonomike-financiare te shoqerise.

NENI 23

Me cilesine e Ekspertit Kontabel te autorizuar te Shoqerise Anonime "INTERMEDICA CENTER" Sh.A, emerohet Zoti, per nje mandat tre vjecar, me te drejte perseritje me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Eksperti kontabel i autorizuar ka per detyre te ushtroje kontroll per ushtrimin e veprimtarise financiare te Shoqerise "INTERMEDICA CENTER" Sh.A, ne perputhje me ligjin.

NENI 24

Problemet e punesimit, dhe probleme te tjera ne lidhje me marredheniet e punes ne Shoqerine Anonime "INTERMEDICA CENTER" Sh. A, do te zgjidhen ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi.
Ne Shoqerine Anonime "INTERMEDICA CENTER" Sh.A, mund te punesohen edhe shtetas te huaj, te cilet do t'i nenshtrohen Legjislacionit Shqiptar per marredheniet e punes. (Shih Nenin 3 te Ligjit 7764, date 02/11/1993 "Per Investimet e Huaja".

NENI 25

Cdo mosmarreveshje lidhur me Interpretimin, Vlefshmerine ose Zbatimin e kesaj Kontrate, do te zgjidhet ose ne Arbitrazhin e Dhomes Nderkombetare te Tregetise se Parisit ose ne Qendren Nderkombetare per Zgjidhjen e Mosmarreveshjeve te Investimeve ("Qendra"), ngritur me Konventen per zgjidhjen e Mosmarreveshjeve te Investimeve ndermjet Shteteve dhe Shtetasve te Shteteve te tjera, miratuar ne Washington me 18 Mars 1965, ne baze te Legjislacionit Francez dhe Parimeve te se Drejtes Nderkombetare.

Kompetenca e ketyre Arbitrazheve eshte paralele ne kuptimin qe paraqitja e Kerkeses ne njerin prej ketyre Arbitrazheve nuk i heq te drejten Pales (Ortakut) t'i drejtohet njekohesisht edhe Arbitrazheve te tjere.

NENI 26

Ky Statut eshte perpiluar ne gjuhet Shqip dhe Anglisht qe kane vlere te barabarte ne interpretimin dhe zbatimin e tij.

Ne rast interpretimi kontradiktor, gjuha baze do te jete gjuha Anglisht.

Nenshkuar ne TIRANE me 21 / 05 / 1996

Ky Statut eshte perpiluar ne 4(kater) ekzemplare origjinale, 2(dy) ne Shqip dhe 2(dy) ne Anglisht.



VASILIS MAGJIRAS

JORGOS PAPAGOCIS

VASIL LLAJO